# Procesverbal

E MARTË
21.06.2022

I mbajtur me rastin e dëgjimit publik për Kornizën afatmesme Buxhetore 2023-2025 (KAB) dhe informatë për qytetarë aktivitetet dhe raportim e punës së Komunës së Suharekës për periudhën Janar - Qershor 2022.

Takimin e hapi Nënkryetarja e Komunës znj. Mihrije Suka. Nënkryetarja përshëndet të pranishmit dhe thotë se janë mbajtë gjithsej 31 takime nëpër fshatra dhe kemi qenë të kënaqur me pjesmarrjen. Është prezantu korniza afatmesme buxhetore dhe janë marrë kërkesat e qytetarëve.

Nënkryetarja ia jep fjalën zyrtarit kryesor financiar z. Fadil Haxha.

Fadil Haxha - përshëndet të pranishmit. Elaboron në pika të shkurtra Kornizën afatmesme Buxhetore dhe thotë që buxheti total është në i realli për 1.5 % dhe pritet të realizohet gjatë vitit 2023. Totali i shpenzimeve kapital për vitin 2023-2025 është 20,112,455.00.

Nënkryetarja - pyet në ka dikush pyetje.

Sali Elshani - Cili është projeksioni i rritjes gjatë këtij viti?

Fadil Haxha - jep përgjigje.

Sali Elshani - Cilat janë lamitë kryesore të cilat i ka Komuna të prioritet?, në ngrit si prioritet?

Fadil Haxha - jep përgjigje.

Nënkryetarja – atëherë po vazhdojmë me raportimet 6 mujore, dhe ia jep fjalën Drejtorit për Shërbime Publike dhe Emergjenca

Enver Shabani – përshëndet të pranishmit. Ai në pika të shkurtra elaboron punën 6 mujore të kësaj drejtorie.
Thotë se ne si drejtori kemi 3,393,762.00 € si total.
Ka pas të reshura të borës dhe asnjë rrugë nuk ka qenë e mbyllur, të gjitha kanë qenë të kalueshme. I kemi kushtuar rëndësi të madhe mirëmbajtjes së qytetit dhe Komuna ka nënshkruar kontratat të reja. Sa i përket shpenzimit buxhetor, ishte minimal.
Ne si drejtori kemi takime të shpeshta me qytetarët, kemi marrë ~~ne~~ parasysh kërkesat dhe shqetësimet e tyre.

Nënkryetarja – raportet do të publikohen edhe në web faqen e Komunës.

Remzi Bajselmani – përshëndet të pranishmit. Ai në pika të shkurtra elaboron punën 6 mujore të kësaj drejtorie dhe flet që ne nuk kemi shumë investime kapitale në DKA. Me pjesën e buxhetit që jane nda për këtë drejtori kemi fi sallën sportive në shkollën fillore Destan Bajraktari e cila është investim i Ministrisë së Arsimit.

Visar Kuçi – përshëndet të pranishmit. Ne si drejtori kemi fillu me hartat zonale dhe jemi në përfundim të procesit. Veç jane në fazën përfundimtare dhe janë shpallur kolektorët e rrugës „Skënderbeu". Si drejtori e kemi pas prioritet legalizimin e objekteve.

Drejtori tutje vazhdon me raportin 6 mujor të kësaj drejtorie dhe tregon për projektet e ardhshme.

Ardian Kotorri – përshëndet të pranishmit. Kemi pas fluks të madh në punë dhe kemi pas pagesë sepse disa projekte kanë dal si rezerve, në bashkëpunim e ministrisë si kategorizim, kemi pas aktivitetin e subvencioneve e cila ka shkuar shumë mirë, ku kemi pas rreth 1200 aplikime. Drejtori tutje vazhdon raportin 6 mujor dhe flet për projektet e ardhshme.

Labinot Hakitjaha – përshëndet të pranishmit dhe flet për raportin 6 mujor të kësaj drejtorie. Ai gjithashtu lut qytetarët, që nëse s'kanë mundësi për pagesë, të vijnë e zgjedhin dhe të bëjnë një marrëveshje që pagesa të kryhet pjesë pjesë në pëngindje, ose ndryshe do të shkojë përmbarues.

Besa Kuçi – përshëndet të pranishmit. Ne si Drejtori e kemi filluar mirë këtë vit. Veç kemi filluar me projekte kapitale. Kemi pranuar donacion në vlerë prej 16 mijë €, donacion italian. Asambleja e ka miratuar bonus-banimin. Do të mbështetemi me 2200€ për shtëpinë e grave të dhunuara Prizren. Kemi rënshkruar edhe projektin me Karitas i cili është 3 vjeçar. Drejtoresha tutje vazhdon me raportin 6 mujor të kësaj drejtorie.

Albulena Kokollari – përshëndet të pranishmit. Ne kemi pas aksionin për pastrimin e ambientit dhe ka qenë dita 2...

...u kemi pastru qytetin me qytetore. Në muarin janë dy gjoba të cilat i kemi inspektu. Në sektorin e tregut janë ponayit dy aktaplikacion e gjykatë. Drejtoresha vazhdon detyrë me raporo 6 mujor të kësaj drejtorie.

Fonika Gashi – përshëndet të pranishmit. Kemi pas telashe edhe me për shkak të vonimit të buxhetit. Investime kapitale i ka 5 për këtë vit dhe tri janë në procedurë. Kemi bo thirrje për subvencione.

Takimi përfundoi: 12:00